



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULATOR I ENERGISJË
BORDI

VENDIM

Nr. 223, Datë 23.10.2024

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 132, DATË 02.07.2024,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SH.P.K.
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGISJË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 979/18 prot., datë 21.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “GreNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 02.07.2024, vendosi të licencojë shoqërinë “GreNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 11.01.2028.
- Shoqëria “GreNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 979/17 prot., datë 19.09.2024, paraqiti kërkesën për modifikimin e datës së hyrjes në fuqi të licencës së dhënë me vendimin e sipërcituar, duke përcaktuar si datë fillimi datën 20.10.2024, pasi ndërtimi i veprës është i ndarë në dy Lote (Loti 1 – 25 MW, 6/35 Kv; Loti 2 – 75 MW) dhe programi i punës parashikon që Loti 1 – 25 MW 6/35 kW do të komisionohet në këtë datë. Po ashtu, shoqëria informon se në referencë të nenit 10 të Kontratës nr. 31 rep., nr. 13/5 kol., datë 27.01.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka marrë masat e nevojshme për të kryer testimin e veprës.

- Rezulton se shoqëria disponon miratimin e Operatorit të Sistemit të Trasmetimit (OST) sh.a. për lidhjen e centralit fotovoltaik të shoqërisë me fuqi 100 MWp me rrjetin e transmetimit, si dhe miratimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes të burimit të ri gjenerues të energjisë fotovoltaike me fuqi të instaluar 25 MW.
- Pra, për sa kërkuar nga ana e shoqërisë për të ndryshuar datën e fillimit të operimit për një pjesë të kapacitetit të instaluar të centralit (atë 25 MW), duke marrë në konsideratë faktin se ajo ka miratimin përkatës nga operatori i rrjetit të shpërndarjes që përkon me këtë kapacitet, vlerësohet se kjo kërkesë është e justifikuar nga ana e saj, ndaj afati i fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar për këtë kapacitet do të jetë data e hyrjes në fuqi të vendimit të bordit ku reflektohet ky ndryshim.
- Nga ana tjetër, fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së licencuar për kapacitetin e mbetur prej 75 MW (i cili do të ndërtohet në fazën e dytë sipas parashikimeve), me hyrjen në operim të të cilit plotësohet kapaciteti i plotë i centralit për të cilin është licencuar shoqëria, duhet të bëhet jo më vonë se data 11.01.2028, afat i cili i referohet përcaktimeve të VKM-së nr. 6/2023 dhe kontratës me MIE-n Nr. 31 Rep., Nr. 13/5 Kol., datë 27.01.2023, për vënien në operim të të gjithë centralit gjenerues të energjisë elektrike. Me vënien në operim të centralit për kapacitetin e plotë, sipas pikës së lidhjes me OST (e miratuar për 100MWp) do të shfuqizohet përcaktimi në lidhje me hyrjen në operim të kapaciteti prej 25 MW.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, ndryshon si vijon:
 1. *Të licencojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.*
2. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5, me përmbajtje si vijon:
 3. *Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike për kapacitetin e instaluar prej 25 MW me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve.*
 4. *Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së licencuar për kapacitetin e plotë prej 100 MW jo më vonë se data 11.01.2028.*

5. *Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij vendimi, pika 3 shfuqizohet.*
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI